




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 dhe neni 26 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikim të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 28.08.2021 merr këtë:



V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e partisë politike “**Nisma Socialdemokrate**” (**NISMA**) dhe listës prej 38 (tridhjetë e tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, listës prej 6 (gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Glogocit, listës prej 12 (dymbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Kaçanikut, listës prej 21 (njëzet e një) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, listës prej 12 (dymbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Kamenicës, listës prej 19 (nëntëmbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën Mitrovicë e Jugut, listës prej 5 (pesë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Lipjanit, listës prej 8 (tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, listës prej 12 (dymbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, listës prej 34 (tridhjetë e katër) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, listës prej 10 (dhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, listës prej 8 (tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes, listës prej 13 (trembëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, listës prej 22 (njëzet e dy) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajt, listës prej 35 (tridhjetë e pesë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, listës prej 34 (tridhjetë e katër) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Malishevës, si dhe nga 1 (një) kandidat për Kryetar të Komunës në Komunën e Gjakovës, Kamenicës, Podujevës, Prizrenit, Vushtrrisë dhe Malishevës, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend në Komunën e Gjakovës, Glogocit, Kaçanikut, Fushë Kosovës, Kamenicës, Mitrovicës së Jugut, Lipjanit, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Skenderajt, Shtimes, Suharekës, Ferizajt, Vushtrrisë dhe Malishevës, si dhe për Kryetar të Komunës në Komunën e Gjakovës, Kamenicës, Podujevës, Prizrenit, Vushtrrisë dhe Malishevës.

- III. Zyra obligohet që të njoftoj partinë politike **"Nisma Socialdemokrate"** për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i çertifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniq



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa – PZAP.